

**AKTIVITETI I SHËRBIMIT LIGJOR
FALAS TIRANË, 2016
(TIRANA LEGAL AID SOCIETY),
TLAS, 2016**

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjatë vitit 2016, ka qënë dhe vazhdon të jetë një ndër aktorët aktiv në procesin e përmirësimit të sistemit të drejtësisë në vendin tonë. Dihet tashmë që ky sistem është nga më të kritikuarit për mos mirëfunksionimin e tij, dhe viti 2016 ishte vendimtar për realizimin e reformës në drejtësi. Perceptimi dhe besimi i qytetarëve për funksionimin e sistemit të drejtësisë dhe performancës së aktorëve të tij institucionalë ka qënë dhe është në nivele të pakënaqshme. Në mënyrë të vecantë korrupsioni dhe keqfunksionimi i sistemit kanë cënuar dhe ndikuar aksesin në drejtësi të qytetarëve. Prandaj dhe shërbimet ligjore falas mbeten një pjesë shumë e rëndësishme e këtij sistemi, sepse janë ato që garantojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve në nevojë si dhe ga-

rantojnë dhënien e një drejtësie bazuar mbi parimin e paanësisë dhe pavarësisë nga ana e gjyqësorit.

TLAS ka dhënë gjatë vitit 2016 ndihmesë shumë konkrete në drejtim të përmirësimit të draft ligjeve të paketës legjislative të reformës dhe në veçanti për ato draft Ligje që ndikojnë shtresat dhe grupet në nevojë. Komentet dhe diskutimet e ekspertëve të TLAS të paraqitura në tryezat parlamentare kryesisht janë fokusuar në projektligjet e shërbimeve ligjore në Republikën e



Shqipërisë, dhe përkatësisht tek: 1) Avokatia 2) Noteria 3) Ndihma Juridike 4) Ndërmjetësimi dhe 5) Shpenzimet e tarifave gjyqësore.

Në këtë kontekst dhe në kushtet që ndihma juridike shtetërore për çështjet civile pothuaj nuk funksionon, TLAS ka advokuar dhe lobuar për nevojën e domosdoshme të shërbimeve ligjore falas të ofruara nga organizatat jo fitimprurëse të specializuara.

Gjatë vitit 2016 TLAS-i zgjidhi **1714** çështje ligjore që i përkisnin fëmijëve, të papunëve, personave me aftësi të kufizuara, pension-

istëve, grupit LGBTI, minoriteteve dhe familjeve të tjera në nevojë. Këta përfitues kanë mbetur të kënaqur nga rezultatet e zgjidhjes sepse më shumë se 96 % e rasteve janë finalizuar me sukses në favor të përfituesve direktë të shërbimit. Përfituesit dëshmojnë dhe vlerësojnë ndihmën juridike që ju ka ofruar TLAS zgjidhja e të cilave ka mundësuar aksesin e tyre në programet sociale dhe përmirësimin e situatës ekonomike.

Gjatë 2016, TLAS ka synuar përfaqësimet ligjore strategjike si përpara administratës shtetërore ashtu dhe para gjykatës, si edhe forcimit të partneritetit efektiv me strukturat shtetërore, me NGO'të partnere apo përfaqësuesit në nivelin lokal në mënyrë që të plotësohet shërbimi ndaj shtresave apo individëve më të marginalizuar, **mbrojtjes së të drejtave të tyre përmes:**

- **Përcaktimit** me përparësi të llojeve të shërbimeve për fëmijët, familjet vulnerabël dhe qytetarët e tjerë të varfër.
- **Përmirësimit** të aftësive të klientëve për të zgjidhur vet



problemet ligjore nëpërmjet trainimit individual dhe në grup me drejtues ose përfaqësues të komunitetit, nëpërmjet ofrimit të formave të gatshme e të lehta për t'u përdorur.

- **Identifikimit** të çështjeve ligjore përmes përdorimit të TLAS WEB Portal, i cili synon të orientojë personat në nevojë si t'i zgjidhin ato.

- **Zgjerimit** të struktures së tij dhe partnerëve apo aktorëve të tjerë qeveritarë dhe joqeveritarë për të ndërtuar besimin te individët në nevojë dhe krijuar një realitet tjetër në funksion të zhvillimeve të mëtejshme të demokracisë në Shqipëri.

- **Rritjes së kapaciteteve** të profesionistëve, seminareve të trajnimit, workshopeve dhe tryezave të shumta në të gjithë vendin

- **Ofrimit të shërbimeve** ligjore mobile, aktiviteteteve të street law, shërbimeve hotline, përdorimit të teknologjisë është bërë e mundur që të përfitojnë individë vulnerabël edhe nga rrethet tjera të largëta si Peshkopia, Gjirokastra, Kukësi, etj.

- **Forcimit të rolit si anëtar** i koalicionëve të BKTF, Justice for All, BRRLN, ENS dhe CHILD PACT.

Edhe pse financimi mbetet një sfidë e vërtetë, TLAS ka arritur të sigurojë mjaftueshëm fonde dhe të jetë eficient në shërbimet e tij, bazuar në shmillojshmerinë e formave të ofrimit, në cilësinë e lartë dhe me kosto të ulët. Pikërisht këtë model po përpiqemi ta promovojmë jo vetëm në Tiranë por edhe në qarqe si Elbasani, Durrësi, Fieri, Berati, Korça, Shkodra, etj. në mënyrë që fondet e donatorëve të përdoren



sa më mirë dhe për t'i shërbyer sa më shumë individëve. Qëllimi i TLAS në këtë analizë vjetore është sa ligjor po aq edhe ekonomik e social. Ne synojmë nga njëra anë të mundësojmë ndryshimet e nevojshme në sistemin e drjetësisë, dhe nga ana tjetër të ofrojmë shërbimet e përditshme për personat që kanë më shumë nevojë, duke sjellë sado pak ndryshim në jetët e tyre dhe në shoqërinë shqiptare.



Një nga synimet ka qënë ngritja e kapaciteteve dhe nxitja e profesionistëve të fushës së arsimit, shëndetësisë, gjëndjes civile, shërbimit social shtetëror, për t'u përfshirë në mënyrë më të koordinuar në funksion të zgjidhjes së halleve të atyre që kanë më shumë nevojë. Së fundmi, TLAS-i pranon se asgjë nga puna që bën nuk do të ishte e mundur pa përkushtimin dhe angazhimin e ekspertëve, anëtarëve të stafit dhe vullnetarëve.

TLAS beson se të gjithë njerëzit duhet të jenë të barabartë përballë ligjit; se drejtësia duhet të jetë njësoj për të gjithë dhe se duhet të ketë një sistem ligjor që është i lehtë për t'u kuptuar dhe për t'u zbatuar. Donatorët që kanë mbështetur programin e TLAS gjatë 2016 kanë qënë **UNICEF, CRD, UNDP, UNHCR, Dutch Embassy, and US Embassy.**

FUSHA E LIGJIT NË OFRIMIN E SHËRBIMEVE

TLAS vazhdoi gjatë vitit 2016 të ofrojë shërbime ligjore për çështjet civile, administrative, familjare dhe të punës si dhe për rastet e shkeljes së të drejtave të njeriut; në formën e këshillimit, dhe të përfaqësimit si në organet administrative edhe në ato gjyqësore. Shërbimi Ligjor Falas i TLAS është i fokusuar tek familjet më të varfra, tek fëmijët vulnerabël, pensionistët, Grupi LGBTI, individë me aftësi të ndryshme, dhe kryesisht duke synuar përfshirjen e tyre sociale.

Numri total i përfituesve të drejtpërdrejtë nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë, TLAS, gjatë 2016 ka qënë **1714** klientë, dhe numri total i të gjithë përfituesve të drejtpërdrejtë gjatë 18 viteve të funksionimit të Shërbimit Ligjor Falas, TLAS, ka arritur shifrën **21231** klientë¹. Përqindja e suksesit të çështjeve të përfaqësuara përpara gjykatave dhe strukturave administrative gjatë 2016 është si më poshtë:

¹ Më poshtë paraqitet diagrama sipas numrit të përfituesve direkt në harkun kohor të 18 viteve

NUMRI TOTAL I ÇËSHTJEVE NË VITE / Janar 1999 - Dhjetor 2016

Lloji i shërbimit të ofruar	Numri i rasteve	Mbyllur në favor të klientit
Përfaqësim në gjykatë	310	93%
Përfaqësim në administratë	594	96 %
Shërbyer me web services dhe kliniks	810	n/a
Total	1714	
Shërbyer përmes lawline	480	n/a

NUMRI TOTAL I RASTEVE NDËR VITE
Janar 1999 - Dhjetor 2016





Tabela më poshte jep pasqyrën e ngarkesës së punës së stafit që ofron shërbime ligjore gjatë vitit

Trajtuar gjatë 2016	Statusi	Jan	Shk	Mar	Prill	Maj	Qer	Korr	Gus	Shta	Tet	Nënt	Dhj	Gjatë 1999-2016
Avokatët	Hapur	170	223	268	324	387	422	466	469	518	580	618	653	8569
	Mbyllur	8	20	30	60	98	138	188	200	255	345	440	537	8453
	Aktive	162	203	238	264	289	284	278	269	263	235	178	116	116
Asistentët Paraligjore	Hapur	298	367	428	477	546	572	675	688	767	866	940	1061	12662
	Mbyllur	40	110	180	270	360	410	490	500	610	710	810	920	12521
	Aktive	258	257	278	207	186	162	185	188	157	156	130	141	141
Totali	Hapur	468	590	696	801	933	994	1141	1157	1285	1446	1558	1714	21231
	Mbyllur	48	130	210	330	458	548	678	700	865	1055	1250	1457	20974
	Aktive	420	460	486	471	475	446	463	457	420	391	308	257	257


Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Për të parë se cila kategori vulnerabël ka përfituar nga shërbimet e TLAS po japim të dhënat si më poshtë:



Përfituesit janë shërbyer si më poshtë:

Grupet e synuara	Paralegal	Avokat	Total
Fëmijët	609	92	701
Nëna kryefamiljare	127	156	283
Individë me aftësi të ndryshme	28	25	53
Të papunë	153	176	329
Të moshuar pa të ardhura	23	18	41
Pensionistë	25	25	50
Familje të tjera në varfëri	96	161	257
Total:2016	1061	653	1714
Total: 1999-2016	12662	8569	21231



Lloji i çështjes	Këshilltar Paraligjor	Avokat	Totali
Regjistrimet e lindjeve të fëmijëve	609	92	701
Të tjera regjistrime civile	81	52	133
Zgjidhje martese	14	198	212
Çështje familjare	12	235	247
Strehim/ Ndhmë sociale	138	0	138
Mbështetje psikologjike	30	0	30
Të tjera	177	76	253
Total: 2016	1061	653	1714
Total 1999-2016	12662	8569	21231

- Llojet e rasteve gjyqësore janë çështje të pensioneve, familjare, përgjegjësi prindërore, kujdestari, mosmarrëveshjet në punë, zgjidhjet e martesës, dhunim i të drejtave të njeriut, raste të diskriminimit dhe regjistrimet e lindjeve.
- Llojet e rasteve administrative të trajtuara janë: regjistrim i lindjeve, regjistrimet civile si ndarjet familjare, martesa, strehim, ndihma sociale, transferimet etj.

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Eksperienca e gjatë 18 vjecare e ka bërë shërbimin e TLAS shumë të njohur për pjesën më të madhe të grupeve të interesit, rrjeteve të organizatave partnere dhe përfituesve, të cilët e dinë shumë mirë si të na gjejnë pranë zyrave tona, përmes telefonit, website, e-mailit dhe Portalit. Tabela e mëposhtme tregon partnerët më të afërt që kanë bashkëpunuar me TLAS gjatë vitit 2016.

Kush i referon rastet në TLAS?	Përqindja
Strukturat e Shërbimeve Sociale, SSHC	13 %
Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, NJMF	18 %
Avokati i Popullit	5 %
Gjykatat e Rretheve	5 %
OJF partnere	9 %
Organizata me bazë komunitare	6 %
Nënpunësit e Gjendjes Civile	12 %
Portali i TLAS, web dhe linja telefonike	14 %
Aktivitetet Street Law dhe shërbimet mobile në komunitet	18 %
Totali	1714 raste or 100 %



Objektivat e përcaktuara nga TLAS për 2016 janë arritur në përputhje me kontratat e nënshkuara me donatorët, edhe pse zhvillimet dhe ndryshimet e diktuar nga reformat e ndërmarra kudo si në sistemin e ekonomisë, atë social, territorial apo të drejtësisë kanë qënë intensive dhe me efekte të drejtpërdrejta në jetët e familjeve apo individëve vulnerabël.

Disa nga takimet e ndryshme të organizuara nga TLAS gjatë 2016 janë të paraqitura si më poshtë:

Reach out meetings

No	Vendi	Data	No i profesionistëve	Tema
1	Elbasan	11.03.2016	35	Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile.
2	Korca	15.03.2016	30	Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile
3	Lezha	21.03.2016	33	Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile
4	Gjirokastra	18.03.2016	20	Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile
5	Durrës	25.03.2016	29	Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile
6	Berat	18.04.2016	35	Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile
8	Kukës	21.04.2016	32	Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile.

Tryeza të rumbullakta dhe diskutimi

	Vendi	Data	No/P	Tema
1	Tirana	29.03.2016	24	Adresimi i ceshtjeve që prekin të drejtat themelore të fëmijëve
2	Durrës	30.03.2016	25	Adresimi i ceshtjeve që prekin të drejtat themelore të fëmijëve
3	Vlorë	20.05.2016	23	Adresimi i ceshtjeve që prekin të drejtat themelore të fëmijëve
4	Dibër	25.05.2016	29	Adresimi i ceshtjeve që prekin të drejtat themelore të fëmijëve
5	Durrës	15.06.2016	40	"Akses i barabartë për fëmijët, barriera, dilema dhe zgjidhje"
6	Tirana	16.12.2016	25	"Reduktimi i pengesave ligjore me të cilat përballen fëmijët në konflikt me ligjin"
7	Tirana	03.11.2016	28	"Fuqizimi i familjeve në nevojë për një akses më të mirë në regjistrimin civil"

Workshop-e

No	Data	Vendi	Tema	No i pjesëmarrësve
1	04.11.2016	Hotel Xheko Imperial, Tirana	Sigurimi i aksesit dhe përfshirjes sociale përmes regjistrimit të lindjeve	31
2	07.11.2016	Hotel Univers, Elbasan	Sigurimi i aksesit dhe përfshirjes sociale përmes regjistrimit të lindjeve	38
3	14.11.2016	Hotel Fieri, Fier	Sigurimi i aksesit dhe përfshirjes sociale përmes regjistrimit të lindjeve	38
4	17.11.2016	Hotel Arragosta, Durrës	Sigurimi i aksesit dhe përfshirjes sociale përmes regjistrimit të lindjeve	28
	TOTAL	4		135

Trajnime

No	Data	Tema e trajnimit	No i pjesëmarrësve	Vendi
1	12.12.2016	Ngritja e kapaciteteve të aktivistëve dhe CBO've, aftësimi i tyre si paralegal në evidentimin dhe orientimin e problemeve ligjore të komunitetit.	25	Hotel "Aragosta", Durrës
2	13.12.2016	Ngritja e kapaciteteve të aktivistëve dhe CBO've, aftësimi i tyre si paralegal në evidentimin dhe orientimin e problemeve ligjore të komunitetit.	27	Hotel "Xheko Imperial", Tiranë
3	14.12.2016	Ngritja e kapaciteteve të aktivistëve dhe CBO've, aftësimi i tyre si paralegal në evidentimin dhe orientimin e problemeve ligjore të komunitetit.	27	Hotel "Imperial", Elbasan
TOTAL	3		79	

Conferences:

No	Data	No/P	Tema	Vendi
1	24.06.2016	50	Mbrojtja dhe siguria e fëmijëve nga krimi kibernetik.	Hotel Tirana International
2	10.06.2016	36	Rritja e mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve.	Hotel Tirana International
3	17.11.2016	35	Pashtetësia dhe çështjet ligjore të lidhura me të.	Hotel Xheko Imperial
	3	121		



Aktivitetet Street Law

	<i>Vendi</i>	<i>Takime dhe shperndarje informacioni</i>	<i>Date</i>
1	Durres, Qemal Mici, school	32 nxënës, 54 publikime	14.01.2016
2	Durres, Naim Frasheri, school	28 nxënës, 40 publikime	24.02.2016
3	Tirane, Myslym Keta, school	27 nxënës, 50 publikime	16.02.2016
4	Diber, Havzi Nela, school	25 nxënës, 60 publikime	01.02.2016
5	Elbasan, Rrapishte	30 qytetarë, 55 publikime	29.01.2016
6	Gjirokaster, Zinxhiraj	40 qytetarë, 60 publikime	23.03.2016
7	Gjirokastër, Zinxhiraj	52 qytetarë , 60 publications	17.03.2016
8	Fush- Krujë, community	34 qytetarë, 40 publikime	27.04.2016
9	Fier, Drize, Roma community	31 qytetarë , 50 publikime	05.05.2016
10	Tirane, QTE	28 qytetarë, 40 publikime	28.09.2016
11	Tirane Bregu i Lumit	42 qytetarë , 60 publikime	04.10.2016
12	Durres, Keneta	37 qytetarë, 55 publikime	16.12.2016
13	Durres, Fabrika e Plastmasit	34 qytetarë , 58 publikime	23.12.2016
14	Tirane Shkoze	40 qytetarë, 60 publikime	06.10.2016
15	Vlore, Skele	42 qytetarë , 65 publikime	11.10.2016
16	Durres Cezmja e Ferres	36 qytetarë, 60 publikime	07.11.2016
17	Durrës, Plastmasi	120 publikime , fletëpalosje e broshura	23.09.2016
18	Tiranë, Tufine, Bregu i lumit	80 publikime, fletëpalosje e broshura	28.09.2016
19	Durrës, Keneta	150 publikime, fletëpalosje e broshura	30.09.2016
20	Elbasan	120 publikime, fletëpalosje e broshura	03.10.2016
21	Tiranë, Kamez Bregu i lumit	120 publikime, fletëpalosje e broshura	14.10.2016
22	Durrës, Shijak	200 publikime, fletëpalosje e broshura	07.10.2016
23	Tiranë, Irfan Tomini	90 publikime, fletëpalosje e broshura	10.10.2016
24	Tiranë, Shkoze	80 publikime, fletëpalosje e broshura	26.10.2016
25	Shkolla 9 vjeçare Divjake	30 nxenes, 50 fletëpalosje e broshura	17.11.2016
26	Shkolla "Pjeter Budi"	28 nxenes, 60 fletëpalosje e broshura	21.11.2016
27	Shkolla " M. Dollaku"	35 nxënës , 65 fletëpalosje e broshura	27.11.2016
28	Shkolla " Sabaudin Gabrani"	32 nxënës, 60 fletëpalosje e broshura	09.12.2016
29	Shkolla Njazi Nastori , Sukth	30 nxenës, 48 publikime	24.11.2016
30	Shkolla 1 Maji Berat	30 nxënës , 42 Publikime	21.12.2016
31	Shkolla Dhora Leka	34 nxënës, 50 publikime	26.04.2016
32	Shkolla Vasil Shanto	28 nxënës, 45 publikime	25.05.2016
33	Shkolla Kongresi I Lushnjës	55 nxënës, 120 publikime	20.10.2016

TLAS dhe rrjetet rajonale gjatë 2016

Si pjesë e Rrjetit Ballkanik të Shtetit të së Drejtës¹, TLAS ishte pjesë e projektit Rajonal "Zgjerimi i mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Maqedoni e Serbi". Ky projekt u impelmentua nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Bosnjë dhe Hercegovinë në Republikën Srpska, në bashkëpunim me organizatat partnere të rajonit me qëllim për të kontribuar në forcimin e sistemit të

mbrojtjes ligjore së të akuzuarve në të pesë vendet e rajonit.

Pika e nisjes për këtë dokument ishte dokumenti "Comparative analysis on the criminal defense advocacy in Albania, Bosnia and Herzegovina, Kosovo, Macedonia and Serbia", në kudër të programit "Rrjeti rajonal i shtetit të së Drejtës (BRRLN)". Analiza krahasuese u përdor për të përcaktuar se si themelimi i një rrjeti rajonal të avokatëve mbrojtës mund të kontribuojë në vendosjen e një sistemi mbrojtjeje të fortë, të pavarur dhe efektive.

¹ Informacion për këtë rrjet mund të gjendet në: <http://www.brrln.org/http/index.php?id=2&mv=1>



Përfundimet e analizës krahasuese lidhur me mbrojtjen ligjore në çështjet penale në të pesë vendet e rajonit si dhe puna e grupeve të punës të cilët diskutuan problemet në funksionimin e mbrojtjes ligjore në çështjet penale, treguan se të pesë vendet e rajonit po përballen me sfida serioze për të siguruar cilësi në aksesin në dretësi për të gjithë shtetasit. Në harmoni me rekomandimet e analizës së

sipërmendur, që e nevojshme të identifikohen çështjet më të rendësishme që lidhen me vendosjen dhe funksionimin e një sistemi transparent të mbrojtjes ex-officio – veçanërisht në çështjet e caktimit të avokatëve, pagesat e avokatëve të përfshirë, kompetencën e tyre e cila i jep tagra për të përfaqësuar si dhe mundësitë për të vendosur modele alternative të mbrojtjes ex-officio. Nga kjo analizë u prodhuan një raport i qenësishëm më veshtrim krahasues mbi të gjitha praktikën e mira e më pak të mira të rajonit, por edhe me rekomandime konkrete për çdo shtet. Pikërisht për Shqipërinë u draftuan në një dokument politikash këto rekomandime të rendësishme për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve:

Rregullore e re e Dhomës me të gjithë rregullat dhe procedurat për t'u ndjekur lidhur me mënyrën e caktimit të avokatëve ex-officio;
Rifreskimi i listës së avokatëve të Dhomës;

Instalimi i softëare-t që do të caktojë avokatët ex-officio;
Sanksione për gjykatat të cilat nuk respektojnë listën;
Tarifa të reja për avokatët ex-officio;
Unifikim i pagesave për të gjitha procedurat ligjore;
Ndryshimi mënyrës së pagesës së avokatëve dhe kryerja e saj bazuar në orët e punës;
Thjeshtim i procedurës administrative për pagesat e avokatëve ex-officio;
Përfshirja e sistemit të ndihmës juridike në sistemin e mbrojtjes ex-officio;
Përcaktimi i përgjegjësisë së plotë të Dhomës për edukimin e avokatëve si dhe për mbajtjen



e të dhënave për çdo avokat që caktohen të përfaqësojnë ex-officio;

Përfshirja e shkeljeve disiplinore në dosjen e çdo avokati;

Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale i cili parashikon se avokati caktohet nga Prokurori.

Si pjesë e Rrjetit European të Pashtetësisë (ENS)², TLAS edhe gjatë 2016 ishte pjesë e aktiviteteve të përbashkëta në kudër të reduktimit të pashtetësisë si dhe advokimit në vend për të identifikuar dhe reduktuar numrin e personave pa shtetësi. Gjatë 2016 edhe si partner me UNHCR, TLAS ka identifikuar dhe ka zgjidhur më shumë se 300 raste të personave të paregjistruar dhe në rrezik pashtetësie. Në fokus dhe një gur themeli i punës sonë në këtë kuadër do të mbeten këto konkluzione të rendësishme të cilat rezultuan nga raporti I përbashkët në kuadër të aktiviteteve të rrjetit:

Pashtetësia nuk konsiderohet ende një çështje në vend.

2 Informacion për këtë rrjet mund të gjendet në: <http://www.statelessness.eu/>

Në këtë kontekst duhet të ketë një dallim të qartë mes regjistrimit civil dhe pashtetësisë në mënyrë që të kuptohet edhe nga autoritetet relevante.

Nuk ka në fuqi një status për personat pa shtetësi. Për më tepër nuk ka një ligj specifik për pashtetësinë po ashtu nuk ka as një kuadër ligjor të përshtatshëm për pashtetësinë.

Një ligj specifik për pashtetësinë do të kontribuonte në një kuadër ligjor të përshtatshëm edhe pse Konventa për statusin e personave pa shtetësi është miratuar.

Boshllëqet në përfitimin e dokumentave të identifikimit dhe të shërbimeve mund të shkaktohet edhe si rezultat i mungesës së shtetësisë.

Personat pa shtetësi në vend duhet të preken po ashtu nga mungesa e dokumentave të identifikimit.

Edhe pse Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile

janë autoritetet përkatëse që meren me procedurat e fitimit të shtetësisë, ato nuk luajnë një rol të rëndësishëm për parandalimin dhe reduktimin e pashtetësisë si dhe në mbrojtjen e të drejtave të personave pa shtetësi. Shqipëria ende nuk e ka ratifikuar Konventën e Këshillit të Europës për "Shmangien e e Pashtetësisë në Kontekstin e Zhvillimit Shtetëror 19.05.2006". Personat pa shtetësi nuk identifikohen personalisht dhe sistematikisht.

Identifikimi i tyre behet vetëm mbi bazë vullnetare dhe ata mund të mbetën pa shtetësi për një kohë të gjatë.

Bazuar në ligj, Zyrat e Gjendjes Civile dhe Policia e Shtetit duhet të identifikojnë të gjithë personat (shtetast shqiptarë, shtetasit e huaj rezidentë të ligjshëm, shtetasit të cilët kanë patur më parë shtetësinë shqiptare por që kanë hequr dorë prej saj dhe personat pa shtetësi) të cilët jetojnë në zonat e tyre të përgjegjësisë dhe t'i regjistrojnë ata në regjistrat e gjendjes

civile. Mungesa e një ligji për pashtetësinë në Shqipëri, krijon boshllëqe ligjore për personat pa shtetësi për të qendruar ligjerisht (të ligjshëm) në vend. Kjo ndikon më së shumti aksesin në shërbime të personave pa shtetësi. Ata trajtohen kryesisht si grupe vulnerabël nga projektet e shoqërisë civile.

Censusi i popullsisë nuk është në gjendje të japë të dhëna të detajuara për personat pa shtetësi që jetojnë në vend.

Asnje studim tjetër shtetëror nuk është ndërmarrë deri më tani nga burime të tjera për personat pa shtetësi. Po ashtu ka mungese të dhënash të detajuara mbi numrin dhe arsyet e mbetjes pa shtetësi.

Për shkak të mungesës së një strategjie zyrtare dhe kuadri ligjor për personat pa shtetësi, nuk është hartuar dhe elaboruar një profil socio-ekonomik bazuar në moshën, seksin, besimin fetar etj.

Monitorimi i Ceshëve Gjyqësore të Rasteve të Krimeve Kibernetike ndaj Fëmijëve dhe Rasteve të Përgjegjesisë Prindërore

Hyrje

Fjalët e para që ndesh sapo klikon faqen e Internetit të UNICEF-it janë, "UNICEF beson se të gjithë fëmijët kanë të drejtë të jetojnë, zhvillohen dhe të përmbushin potencialin e tyre për të fituar një botë më të mirë". Ne

¹ UNICEF website



jemi krenarë që kemi ndarë dhe vazhdojmë të ndajmë të njëjtin slogan me UNICEF-in për më shumë se 18 vite. Që në themelimin e tij, TLAS-i ka pasur si prioritet mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri. Qëllimi që fëmijët shqiptarë të gëzojnë të njëjtat të drejta si ata në botën e zhvilluar, është i lidhur pashmangërisht me ekzistencën tonë.

Një arsye shtesë për t'a filluar këtë raport me fjalët e para të faqës së Internetit të UNICEF-it ishte për të materializuar me një shembull zhvillimet e shpejta teknologjike, të cilat kanë përfshirë Shqipërinë si pjesën më të madhe të botës. Nuk u deshën më shumë se pak sekonda për të aksesuar faqen e UNICEF-it dhe çdo gjë që ajo ka për të ofruar. Aksesimi në informacion, ide, të mira dhe shërbime ka arritur nivele të paimagjinueshme vetëm për 20 vite. Fëmijët, në Shqipëri dhe gjetkë, jetojnë skajet e këtij progresi. Megjithatë përfitimet janë të panumërta, ky progres sjell dhe rreziqe të

reja. Për të qenë të realist, në fakt, nuk është teknologjia që krijon këto rreziqe, por dëshirat e prapshita që mund të gjejnë mbështetje në këto zhvillime. Ka një sasi të gjerë provash që përdoruesit e rinj të Internetit mund të bien shpesh pre e keqtrajtim-it, abuzimit seksual, emocional e financiar gjatë qëndrimit online.

Në këtë kontekst, kur 10 muaj më parë UNICEF dhe CSO lajmëruan për një projekt të ri në mbështetjen e kërkesave për drejtësi të fëmijëve, ne propozuam një studim sistematik të problemit të krimeve kibernetike ndaj të miturve. Deri më sot, me pak përjashtime², projektet mbi luftën kundër krimeve kibernetike në Shqipëri kanë qenë të fokusuar në mashtrimet financiare, pastrimin e parave dhe mbështetjen e terrorizmit me anë të hapësirës virtuale. Për këtë arsye, ishte i nevojshëm një vlerësim i situatës së përgjithshme për problemin në fjalë. Falë bashkëpunimit të Gjykat-

ave të Rretheve Tiranë, Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër dhe Fier, Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, strukturave përkatëse të prokurorisë dhe shumë ekspertëve të fushës, ky raport, ndërmjet të tjerave, paraqet një pikturë të plotë të situatës, si nga ana teorike, i.e. konteksti ligjor dhe pikëpyetjet përkatëse, dhe nga ana praktike, i.e. sa raste, sa zgjasin dhe si përfundojnë çështjet e krimeve kibernetike ndaj të miturve në gjykatë. Kjo përmbledhje ndihmon në arritjen e një numri konkluzionesh dhe rekomandimesh për përmirësimin e gjendjes.



² A Study on Child Online Safety in Albania, World Vision Albania, <http://www.wvi.org/albania/publication/study-child-online-safety-albania>



Pjesa e dytë e raportit fokusohet në përgjegjesinë prindërore dhe foster care. Këto çështje kanë të njëjtën peshë për jetën e fëmijëve, si ato të sipërpërmendurat. Në fakt, dhe pse një krahasim midis të dy llojeve të problemeve nuk është në qëllimet e këtij raporti, mund të themi se ato që lidhen me kujdestarinë kërkojnë një përgjigje më urgjente për dy arsye. E para, ndërkohë që krimet kibernetike janë një fenomen relativisht i ri, të cilin dhe vende të zhvilluara po hasin vështirësi t'a adresojnë, problemet e foster care

dhe kujdestarisë përfaqësojnë pengesa të vjetra për fëmijët shqiptarë. Së dyti, problemet e kujdestarisë mund të bëjnë që fëmijët përkatës të jenë pre më të lehta të agresorëve në botën virtuale. Fëmijët e neglizhuar janë apriori më vulnerabël ndaj "grabitqarëve" seksualë.

Si në seksionin e krimeve kibernetike, një trajtim holistik i situatës ishte i nevojshëm për të listuar konkluzionet dhe sugjerimet tona. Në këtë drejtim, monitorimi i çështjeve të këtij tipi në Gjykatën e Rrethit Shkodër na paraqiti një imazh më të qartë rreth çfarë po funksionon si duhet, çfarë jo, dhe ç'mund të bëhet për të përmirësuar situatën.

Krimet kibernetike kundër fëmijëve

Abuzimi ndaj fëmijëve, e veçanërisht ai seksual, është një shqetësim për pothuaj të gjitha shoqëritë i cili, është materializuar me anë të ligjeve të brendshme dhe marrëveshjeve

ndërkombëtare. Në këtë kontekst, duke parë zhvillimet e vrullshme teknologjike, sidomos "revolucionin e Internetit", rreziqet për abuzim janë rritur ndjeshëm, ndaj dhe legjislacionet vendore dhe marrëveshjet ndërkombëtare janë transformuar dukshëm.

Mundësia për të krijuar dhe shpërndarë materiale pornografike në hapësirën kibernetike, ose për të kontaktuar fëmijët në Internet, janë kthyer në çështje kyçe pas viteve 90', pasi individë me preferenca pedofilie filluan të shfrytëzojnë progresin teknologjik për qëllimet e tyre. Rreziqet janë rritur në mënyrë eksponenciale duke parë dhe: i) karakteristikat e teknologjisë së informacionit si lehtësia në përdorim, mungesa e pengesave, dobësimi i kufijve shtetërorë dhe principit territorial, lehtësia për të kontaktuar viktimën e të tjera; ii) mundësitë që vijnë nga globalizimi, që lidhet me lëvizjen e lirë të njerëzve, të mirave, shërbimeve dhe ideve, iii) paqartësitë ligjore, si kon-

ceptuale dhe operative, psh. bota virtuale është e vështirë të përkufizohet e rrjedhimisht të rregullohet me legjislacionet e botës reale. Ndaj, shprehja që "krimi është gjithmonë një hap para" është më e vertëtë së çdokund tjetër në këtë fushë.

Shqipëria nuk përbën përjashtim nga pjesa e botës së zhvilluar rreth rreziqeve që fëmijët ndeshin online. Një studim nga World Vision³ zbulon se 44% e fëmijëve shqiptarë vizitojnë të paktën një herë në ditë faqe

3 A Study on Child Online Safety in Albania



pornografike dhe 47% e fëmijëve janë kontaktuar të paktën një herë nga një i panjohur online. Këto statistika tregojnë që rreziku që fëmijët shqiptarë të bien pre e joshjeve pedoflike janë qënësore.

Legjislacioni që lidh krimet kibernetike dhe dëmtimin e fëmijëve në Shqipërin përfshin Nenin 108/4, "Vepra të turpshme" dhe Nenin 117, "Pornografia", të Kodit Penal. Këto aspekte të krimit kibernetik rrallëherë kanë marrë vëmendje (të paktën në Shqipëri) në studime akademike apo raporte. Sidoqoftë, urdhri 135/1, i datës 10.06.2014, i Prokurorit të Përgjithshëm i ka listuar

shkeljet e ligjeve të mësipërme si pjesë të veprave speciale penale nën autoritetin e sektorit të krimit kibernetik.

Është e qartë që dy cilësitë qëndrojnë në proporcion të zhdrejtë me njëra-tjetrën, prandaj modelet e pyetësorëve janë përpjekje për të optimizuar të dy karakteristikat.

Ndërkohë që dhunimet e përshkruara nga "Vepra të turpshme" dhe "Pornografia" janë pjesë të akteve tipike (jashtë Shqipërisë) kibernetike kundër fëmijëve, veprat që përfshihen nën "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasurisë" duken si raste atipike për kategorinë në fjalë. Sidoqoftë, të dhënat tregojnë se kjo vepër penale, parashikuar nga Neni 109/b/1 i Kodit Penal, është forma më e përhapur e krimeve kompjuterike kundër fëmijëve. Në ndryshim nga dy nenet e mësipërme, shkelje të kësaj natyre klasifikohen si krime të rënda dhe ndaj janë në juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së I



për Krimet e Rënda⁴.

Joshja Seksuale ndaj Fëmijës (Vepra të turpshme)

Joshja seksuale ndaj fëmijës (Child grooming), që parashikohet nga Neni i "Vepra të turpshme", përkufizohet si krijimi i një lidhje emocionale me një fëmijë për të mundësuar abuzimin seksual me të. Ky abuzim përfshin trafikimin e fëmijëve, bizneset e paligjshme si prostituimi i tyre ose prodhimin e pornografisë me fëmijë.

Fëmijët mund të joshen përmes Internetit ose në botën e vërtetë nga një i panjohur – megjithëse "grabitqari" seksual mund të jetë dikush i afërt me fëmijën, psh. një familjar, mik i familjes, një mësues e kështu me radhë. Sipas studimeve të ndryshme, këta individë mund të jene të moshave dhe gjinive të ndryshme. Tërheqja online zakonisht ndodh në dhoma të hapura chati, megjithëse mund të realizohet dhe nëpërmjet mesazheve personale dhe e-

⁴ "Pornografia" dhe "Vepra të turpshme" gjykojnë nga gjykatat e rretheve

maileve. Shpeshherë, kjo joshje është e shpejtë, duke qenë se fëmijët priren të besojnë më shpejt dikë që njohin online se dikë që njohin ballë për ballë.

Shpesh, agresorët e prezantojnë veten si të njëjtës moshë me viktimën. Ata fillojnë komunikimin duke ofruar këshilla për probleme që mund të shqetësojnë të miturin. Agresorët mund të mbledhin informacion paraqak për viktimat duke përgjuar të dhënat e këtyre të fundit në Internet. Fëmijët, më të shumtit të lënë pas dore nga prindërit ose kujdestarët, joshen nga vëmendja e ofruar. Pas fazës fillestare, agresori përpiket të



izolojë fëmijën nga prindërit dhe miqtë, në mënyrë që t'a bëjë plotësisht të varur ndaj vetes. Për më tepër, këta të fundit mund të përdorin "sekretet" të besuara nga viktima, për t'a kërcënuar apo kontrolluar fëmijën.

Legjislacioni shqiptar e parashikon këtë sjellje në Nenin 108/4, "Vepra të turpshme",

"Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërmëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka

arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet⁵."

"Veprat penale të parashikuara në këtë seksion i referohen akteve heteroseksuale ose homoseksuale me të mitur, akteve seksuale në hapësira publike, inçestin dhe përdhunimin, ndërkohë që "veprat penale të parashikuara në seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi" përfshijnë prostituimin, pornografinë, shpifjen dhe përndjekjen. Ndaj, joshja seksuale ndaj fëmijëve mund të jetë e motivuar si nga dëshira pedofilike, ashtu dhe për qëllime përfitimi.

Koncepti i "Joshjes Seksuale" është bërë pjesë e legjislacionit shqiptar vetëm kohët e fundit, pas ratifikimit të "Konventës së Këshillit Europian për Mbrojtjen e Fëmijëve ndaj Abuzimeve dhe Shfrytëzimeve Seksuale" (Kon-

⁵ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.



venta e Lanzarotes), dhe implementimit të tij pas ndryshimeve në Kodin Penal me anë të Ligjit nr. 144/2013. Sidoqoftë, Konventa e Lanzarote-s përqendrohet te mbrojtja e fëmijëve në rrjet, ndërkohë që legjislacioni shqiptar ka një fokus më të gjerë dhe Neni 108 i referohet "joshjes seksuale ndaj fëmijëve me çdo mjet dhe formë". Në fakt ky fenomen është përhapur kryesisht nga zhvillimet teknologjike, megjithëse, teorikisht është i mundshëm dhe në mungesë të kësaj teknologjie.

Neni 108/4 mund të jetë problematik në implementim, duke parë se duhet provuar që agresori ka qëllim kryerjen e një veprë penale dhe kur kjo e fundit nuk është materializuar. Neni 6 i Direktivës 2011/92/EU i Parlamentit të Bashkimit Europian dhe Këshillit Europian ofron një zgjidhje interesante në këtë drejtim, ". . . propozimi, me anë të mjeteve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit, të një të rrituri për të takuar një fëmijë, me qëllimin për të kryer njërën nga veprat e mëposhtme . . .



kur ky propozim ndiqet nga një akt konkret për të marrë një takim, është i dënueshëm me burgim dëri në një vit . . .⁶

Kjo frazë sqaron se qëllimi i dhunuesit mund të vlerësohet nga "akte konkrete për të marrë një takim të mundshëm."

Pornografia

Në dekadën e fundit, ka pasur ndryshime të qënësishme në legjislacionin tonë përsa i përket

6 DIRECTIVE 2011/92/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 13 December 2011 on combating the sexual abuse and sexual exploitation of children and child pornography, and replacing Council Framework Decision 2004/68/JHA



luftës kundër krimit kibernetik, të cilat kanë ndihmuar, ndër të tjera dhe mbrojtjen më të mirë të fëmijëve ndaj këtyre rreziqeve. Si një rast konkret mund të përmendim amendimet që i janë bërë Nenit 117 të Kodit Penal, "Pornografia". Nga një pikëpamje kronologjike, transformimet e këtij neni e kanë shndërruar këtë vepër penale nga një kundravajtje në një krim. Këto amendime janë realizuar në 2008 përmes Ligjit nr. 9859 dhe në 2013 përmes Ligjit nr. 144.

Sot, Neni 117 i Kodit Penal parashikon, "Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim deri në dy vjet."

Paragrafi i dytë i Nenit 117 përqendrohet tek "prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë". Faza me çdo mjet ose formë përfshin ipso fact teknologjinë e informacionit, pajisjet kompjuterike, hardëare dhe softëare. Përsa i përket këtyre të fundit, stafi i TLAS ka qenë prezent, në rolin e vëzhguesit, në një gjyq të lidhur me këtë temë në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë nuk ekziston një përkufizim formal i konceptit të pornografisë dhe kjo mangësi

mund të sjellë probleme në implementim dhe në gjykim. Sipas informacionit të mbledhur, na rezulton se gjykatat, në të tilla raste, i referohen përcaktimit të ofruar nga konventat në të cilat aderohet Shqipëria. Sidoqoftë, kjo përjasje mund të jetë shpesh e paqartë duke parë se Shqipëria ka ratifikuar më shumë se një konventë, dhe secila prej tyre ka një përkufizim të saj, paçka të ngjashëm, të termit. Në fakt, Neni 117 reflekton implementimin e obligimeve të mëposhtme, të cilat Republika e Shqipërisë i ka ndërmarrë nëpërmjet marrëveshjeve ndërkombëtare:

1. Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve mbi mbi shitjen, prostituimin dhe shfrytëzimin pornografik të fëmijëve, ratifikuar nëpërmjet Ligjit nr. 9834, datë 22.11.2007.

2. Konventa kundër Krimit Kibernetik e Këshillit Europian, ratifikuar nëpërmjet Ligjit nr. 8888, datë 25.4.2002.



3. Konventa e Këshillit Europian për Mbrojtjen e Fëmijëve ndaj Abuzimeve dhe Shfrytëzimeve Seksuale" (Konventa e Lanzarotes), ratifikuar nëpërmjet Ligjit nr. 10 071, datë 9.2.2009.

4. Direktiva 2011/92/EU e Parlamentit të Bashkimit Europian dhe Këshillit Europian i 13 Dhjetorit të 2011, mbi luftën kundër abuzimit dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve dhe pornografisë me fëmijë, që zëvendëson Vendimin e Këshillit 2004/68/JHA.



Kanosja për Marrjen e Pasurisë

Kanosja për marrjen e pasurisë, së cilës në këtë rast mund t'i referohemi dhe si kanosje kibernetike, është të paktën në terma numerikë, rreziku më i madh me të cilët ndeshen në rrjet fëmijët në Shqipëri. Rasti tipik i këtij fenomeni konsiston në fëmijë që kërcënohen nëpërmjet Facebook-ut (ose mediave të tjera sociale) nga përdorues anonimë në këmbim të të mirave materiale (kryesisht para, por shpesh edhe sende me vlerë). Neni 109/b/1 i Kodit Penal, "Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për dhënien e pasur-

isë⁷", parashikon:

"Shtrëngimi me anë të kanosjes ose dhunës për të kryer ose mos kryer një veprim të caktuar, për të fituar padrejtësisht pasuri ose çdo lloj përfitimi tjetër, për vete ose për të tretë, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet⁸."

Nga vëzhgimi i drejtpërdrejtë dhe nga konsultimet me gjyqtarë, ky ligj duket i përshtatshëm për të adresuar si kanosjet me anë të teknologjisë si ato pa të. Me informacionin e mbledhur deri më tani, nuk vërejmë ndonjë paqartësi të ligjit apo ndonjë nevojë për amendime. Nga ana tjetër, implementimi i këtij ligji has probleme serioze. Prokuroria nuk ka mjetet, personelin apo ekspertizën e nevojshme për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase një numri në rritje të kanoseve kibernetike. Në disa raste, prokurorisë i është dashur më shumë se 1 vit për të përgatitur një çështje pas denoncimit fillestar. Gjithsesi ky problem nuk është i limituar

⁷ Në ndryshim me veprat e sipërpërmendura, Neni 109/b/1 është nën juridiksionin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda.

⁸ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

vetëm për zyrën e prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, por është kryesisht një shqetësim me të cilin ndeshen të gjithë institucionet që luftojnë krimin kibernetik në Shqipëri. Raporti i iProceeds i 2016 përmbledh me fjalët e mëposhtme, “Megjithëse situata është përmirësuar deri diku në vitet e fundit, duke qenë se në Tiranë dhe në çdo rreth ka të paktën një prokuror të veçantë të specializuar në krimin kibernetik, vlerësimi i përgjithshëm është se mungon ekspertiza e nevojshme, sidomos ajo e lidhur me përdorimin e pajisjeve elektronike. Një situatë e ngjashme vihet re dhe me gjyqtarët”.⁹

Raste të Krimeve Kibernetike ndaj Fëmijëve (Prokuroria)

Ky seksion paraqet vetëm një përmbledhje dhe një analizë të shkurtër të informacionit të marrë nga zyrat e prokurorisë pranë Gjykatave të rretheve Tiranë, Elbasan, Vlorë, Korçë, Shkodër

dhe Fier. Për informacion më të detajuar, Shtojca 1 përfshin pyetësin e plotë dërguar këtyre zyrave së bashku me përgjigjet respektive. Të dhënat drejtojnë drejt 4 aspekteve të rëndësishëm:

1) Disa nga pyetjet nuk mund të merrnin përgjigje për shkak se bazat e të dhënave nuk ishin organizuar në mënyrë të tillë që t'a lejonin, psh, sa raste, në të cilat të paktën një nga të mbrojturit ishte i mitur janë regjistruar gjatë kësaj periudhe ose sa raste, në të cilat të paktën një nga vikti-



⁹ iProceeds's Advisory mission and workshop on online fraud and other cybercrime reporting mechanisms

mat ishte i mitur janë regjistruar gjatë kësaj periudhe, dhe të tjera. Fatmirësisht, informacion i ngjashëm me atë të kërkuar in prej nesh ishte i gjendshëm.

2) Numri i të miturve, viktimë apo të akuzuar, për krime kibernetike është jashtëzakonisht i vogël.

3) Krimet kibernetike zakonisht raportohen nga policia, ndërkohë që qytetarët duken ose të pandjeshëm ose të pavetëdijshëm për të denoncuar këto lloj krimesh.

4) Një pjesë shumë e vogël e këtyre çështjeve shkon në gjyq (4%

në 2015 dhe 3.4% në 2016). Kjo nënkupton që ose një shumicë dërmuese e denoncimeve janë të pasakta, ose që prokuroria nuk ka mjetet e duhura për t'i mbuluar të gjitha këto raste¹⁰.

Raste të Krimeve Kibernetike Ndaj Fëmijëve (Gjykatat e Rretheve)

Pyetësi i plotë së bashku me përgjigjet përkatëse mund të gjendet në Shtojcën 2. Gjetjet kryesore mund të përmbledhen:

1) Numri shumë i vogël i çështjeve kibernetike, me autorë ose viktimë të mitur, konfirmohet nga përgjigjet e ofruara nga Gjykatat e Rretheve. I vetmi rast që lidhet me një të mitur është kur ka qënë i akuzuar për vepra penale kibernetike dhe jo viktimë e tyre. Sidoqoftë, gjatë një kontrolli më të detajuar të dosjeve në këto gjykata gjatë periudhës 2015-tetor 2016, stafi i TLAS "zbuloi" një çështje gjyqësore, ku i akuzuari ishte gjetur fajtor për shpërndarje të por-

¹⁰ Një kombinim i të dy problemeve mund të jetë më i mundshmi.



nografisë me fëmijë. Personeli i gjykatës përkatëse na shpjegoi që në këtë rast, viktimat kishin qenë të mitur jashtë Shqipërisë, të cilët nuk mund të identifikoheshin gjatë gjyqit, dhe për këtë arsye rasti nuk ishte klasifikuar në kategorinë e kërkuar nga ne.

2) Ndërkohë që kishte një numër të madh rastesh të joshjeve seksuale (vepra të turpshme) gjatë kësaj periudhe, asnjë nga këto raste nuk ishte kryer me ndihmën e teknologjisë kompjuterike. Kjo mospërputhje na jep të paktën të drejtën e dyshimit që çështje të tilla nuk raportohen, pasi fëmijët ndjehen të turpëruar apo fajtor për të treguar¹¹.

3) Rastet me objekt gjykimi "Pornografinë" zgjasin relativisht më shumë (megjithëse duke pasur vetëm një rast të tillë, ky përfundim është i limituar).

II.iv. Raste të Krimeve Kibernetike Ndaj Fëmijëve (Gjykata e Shkal-



lës së Parë për Krime të Rënda) Pyetësi dhe përgjigjet përkatëse janë të përfshira në Shtojcën 3. Pikat kryesore janë përmbledhur më poshtë:

1) Kanosja për marrjen e pasurisë me anë të rrjetit është krimi kibernetik më i shpeshtë që kërcënon fëmijët në Shqipëri.

2) Në shumicën e rasteve të akuzuarit janë gjithashtu të mitur.

3) Të gjithë të miturit, të cilët janë nxjerrë në gjyq për këto akuza, janë gjetur fajtor gjatë periudhës 2015-tetor 2016.

¹¹ Numri i madh i rasteve të joshjes seksuale ndaj fëmijëve tregon që individët me tendencë pedofilike nuk janë të paktë në Shqipëri. Nuk duket shumë e mundur që këta individë nuk kanë përdorur zhvillimet e reja teknologjike për avancimin e dëshirave të tyre.



Konkluzione dhe Rekomandime

1) Duke parë rritjen e përgjithshme të aksesit në rrjet, Shqipëria nuk mund të klasifikohet më si një vend me pak rrezik në lidhje me krimin kibernetik. Ndaj, përmirësimet e mëtejshme institucionale duhet të jenë të krahasueshme me ato të vendeve të zhvilluara.

2) Faktori i qëllimit në Nenin 108/4 mund të sjellë ngatërresa, pasi duhet provuar që i akuzuari ka qëllime për të kryer aksionet

e cilësuar edhe kur këto nuk materializohen.

Një zgjidhje e mundshme e problemit do të ishte përcaktimi i kushteve sipas të cilave qëllimi mund të vlerësohet, psh. si në rastin e Nenit 6 të Direktivës 2011/92/EU, ku qëllimet e të akzuarit mund të provohen nga "akte konkrete për të marrë një takim të mundshëm."

3) Neni 117/1 nuk përcakton, të paktën jo në mënyrë direkte, vendet e ndaluara për shpërndarjen e pornografisë në hapësirën virtuale.

4) Kjo mund të korrigjohet duke specifikuar drejtpërdrejtë adresat e emailit të fëmijëve apo rrjetet sociale, e kështu e me rradhë. Në këtë mënyrë mund të shmangen ngatërresa të mundshme që kanë të bëjnë me faqe pornografike ku mund të futen edhe të mitur.

5) Mungesa e një përkufizimi të qartë të pornografisë në Kodin Penal mund të jetë problematike, duke parë që secila kon-

ventë, ku Shqipëria aderon, përdor një përcaktim të vetin.

Ky problem zgjidhet lehtësisht duke futur përkufizimin në fjalë në Kodin Penal.

6) Prokuroria dhe gjykatat kanë mangësi në personel, ekspertizë dhe mjete për t'iu përgjigjur në mënyrë efikase rritjes eksponenciale të rasteve të krimit kibernetik.

Teorikisht, ky problem kërkon trajnimin e kapaciteteve dhe blerjen e mjeteve më moderne. Sidoqoftë, në praktikë kjo gjë nuk është e lehtë, por nuk është qëllimi i këtij studimi të merret me një temë kaq të gjerë, që me shumë mundësi kërkon një kërkim individual vetëm për të.

7) Nga eksperiencia e drejtpërdrejtë, bazat e të dhënave të gjykatave, por sidomos ato të zyrave të prokurorisë, janë të organizuara jo në mënyrë optimale dhe faqet zyrtare të Internetit, me disa përjashtime, janë të paaksesueshme për më të shumtën e kohës.



Gjykata e Shkallë së Parë për Krimet e Rënda dhe Gjykata e Rrethit Tiranë mund të shërbejnë si modele, pasi të dyja kanë baza të dhënash dhe faqe Interneti funksionale dhe të organizuara.

8) Numri i vogël i denoncimeve nga qytetarët vetë për krimet kibernetike, tregon një nevojë për rritjen e vetëdijes publike rreth kësaj teme.

Përgjegjësia Prindërore

Në terma të përgjithshëm, "përgjegjësia prindërore" i referohet një grupi të drejtash dhe privilegjesh që kanë fëmijët në lidhje me prindërit e tyre dhe me ata të rritur, të cilët kanë një rol të rëndësishëm në jetën e fëmijës. Këto përgjegjësi përfshijnë si kohën prindërore ashtu edhe përgjegjësinë e marrjes së vendimeve.¹² Ky koncept është formuluar gjerësisht nga Nenet 5 dhe 18/1 të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijës. Për sa i përket ligjit shqiptar, Neni 215 i Kodit të Familjes citon, "Përgjegjësia prindërore përf-

shin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirëritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij¹²."

Përgjegjësia prindërore i përket të dy prindërve, por mund të ushtrohet edhe vetëm nga njeri prej të dyve, ose nga asnjëri. Kjo e fundit mund të ndahet në tri raste, kur te dy prindërit kanë humbur përgjegjësinë prindërore, kur përgjegjësia prindërore i është hequr (do të detajohemi në lidhje me ndryshimin ndërmjet humbjes dhe heqjes së përgjegjësisë prindërore më vonë) ose kur ata janë të pazotë për t'a ushtruar atë.

Rreth pikës së fundit, Neni 224 i Kodit të Familjes, "Pamundësia e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore", pohon: "Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur,

¹² Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë.



janë në pamundësi të ushtruar përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t'i besohet një anëtarit të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familjeje kujdestare ose edhe një institucioni të përkujdesjes¹³."

Gjykimi nëse pazotësia për të ushtruar përgjegjësinë prindërore është e përkohshme apo e përhershme bëhet rast pas rasti. Mungesa e prindit ose sëmundje serioze të tyre mund të jenë të përkohshme. Në secilin rast, gjykata duhet të vendosë bazuar në interesin më të mirë të fëmijës. Fraza "pazotësia për të vepruar" përfaqëson një kufi të mjegullt, veçanërisht në rastet kur ajo është rezultat e një mangësie mendore. Në këto raste është e rëndësishme për personin që po gjykohet si i pazotë për të mbajtur përgjegjësi personale, që kjo zotësi për të vepruar t'i hiqet me vendim gjykatë sipas Kodit Civil.

¹³ Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë.

Përgjegjësia prindërore mund të hiqet sipas Nenit 228 të Kodit të Familjes, "Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmeve të fëmijës ose të prokurorit, mund t'i hiqet përgjegjësia prindërore. Heqja e përgjegjësisë prindërore bëhet me vendim të gjykatës, duke u thirrur si i paditur prindi, për të cilin kërkohet kjo heqje¹⁴."

¹⁴ Kodi i Familjes dhe Legjislacioni për Birësimet i Republikës së Shqipërisë.





Përkufizimet dhe interpretimet e termit “shpërdorim” dhe “pakujdesi” janë të një rëndësie të madhe këtu. Sipas fjalorit shqip-shqip, folja “shpërdoroj” i referohet “përdorimit të papërshtatshëm ose përdorimit të tepruar të diçkaje” ose të një veprimi që është në kundërshtim me ligjin ose parimet morale, duke shpërdoruar detyrën dhe besimin e të tjerëve për përfitime personale.” Përsa i përket “pakujdesisë”, ajo përkufizohet si “dështimi për të ushruar kujdes në jetën dhe detyrat e përditshme.” Duke përdorur këto

përkufizime, situatat bëhen më të qarta. Një prind i cili përdor në mënyrë jo të duhur ose në mënyrë të tepruar të drejtat e tij/saj, ashtu si janë të përcaktuara në ligj ose dështon të ushtrojë kujdes ndaj fëmijës së tij/saj mund ti hiqet përgjegjësia e tij/saj prindërore. Megjithatë, sipas Nenit 230 të Kodit të Familjes, përgjegjësia prindërore mund të kthehet kur kushtet të cilat e shkakuan heqjen pushojnë së ekzistuari.

Si fillim, humbja e përgjegjësise prindërore, përkundër heqjes, është e pakthyeshme. Së dyti, teorikisht, heqja e përgjegjësise prindërore është rezultat i papërgjegjshmërisë së prindit, ndërsa humbja ndjek sjelljen kriminale, kështu që heqja është një sanksion civil, ndërsa humbja është sanksion penal. Së treti, humbja e përgjegjësise prindërore, ndryshe nga heqja, mund të vijë edhe si një ndëshkim plotësues.

Kujdestaria / Foster Care

Në terma të përgjithshëm, foster care i referohet vendosjes së një fëmije, i cili është lënë pa kujdes prindëror, në një institucion të shtetit ose të një kujdestari ligjor, i njohur si prind kujdestar. Fatkeqësisht, në Shqipëri, fëmijët në këtë situatë përballen me rrethana të vështira, për shkak të gjykimeve të tejzgjatura (shpesh në mënyrë të paarsyeshme) dhe me një mbështetje pothuajse inekzistente për familjet kujdestare nga institucionet vendore. Nga ana tjetër, numri i konsiderueshëm i fëmijeve të keqtrajtuar në institucionet shtetërore ka vënë në dukje nevojën urgjente për deinstitutionalizim.

Pozicioni i familjeve kujdestare në Shqipëri shpjegohet nga Kodi i Familjes, me anë të neave të mëposhtëm: Neni 155 --> Pasojat e zgjidhjes së martesës "...Në rast se gjykata arrijnë në konkluzionin se fëmija, përkohësisht, duhet t'i besohet një personi tjetër ose një

familje kujdestare...."; Neni 224 --> Pamundësia e ushtrimit të përgjegjësisë prindërore "Në qoftë se prindërit e fëmijës kanë vdekur, janë në pamundësi të ushtrojnë përgjegjësinë prindërore për shkak të pazotësisë për të vepruar, të mungesës ose për arsye veçanërisht të rënda, fëmija mund t'i besohet një anëtar të familjes, një personi të caktuar si kujdestar, një familje kujdestare ..." Neni 266 --> Familja kujdestare "Familja kujdestare është një familje alternative, e vendosur nga gjykata, për t'i ofruar fëmi-



jës një mjedis familjar, kushte për mirëritje, përkujdesje fizike dhe mbështetje emocionale. Evidentimi i familjeve kujdestare është përgjegjësi e sektorit të ndihmës dhe shërbimit social pranë bashkisë ose komunës ku banon i mituri, e cila realizohet me firmosjen e një deklarate gatishmërie nga familja për te marre fëmijë ne kujdestari.

Proçesi i Monitorimit

Duke qenë se ne jemi të përqendruar në përdorimin e litigimit strategjik për çështje të ndryshme, disa prej të cilave

janë të lidhura me “Përgjegjësi në prindërore” –të fokusuara në mënyrën si gëzohet nga prindërit, në mënyrën si hiqet nga gjykata dhe në mënyrën si zëvendësohet me kujdestarinë/mbrojtjen e të miturit ishtë e nevojshme të merrej informacion rreth çështjeve të mëparshme dhe atyre që vijonin në gjykatë me këto objekte gjykimi. Nga takimet e mbajtura në 18 qytete të Shqipërisë, “zbuluam” se në Shkodër, shërbimet foster care ishin pjesë e një programi pilot të filluar para më shumë se tre vitesh, dhe se gjykata kishte vendosur për një numër të madh çështjesh të këtij tipi gjatë kësaj periudhe.

Nga monitorimi i kryer, ne përfuam një kuptim më të saktë të problemit, duke përfshirë perceptimet dhe interpretimet e ligjit të aktorëve kryesorë. Nga ky informacion i përftuar drejtpërdrejtë, besojmë që pikat e forta dhe dobësitë e këtij proçesi në Shkodër mund, respektivisht, të kopjohen ose përmirësohen për praktika më të mira në të ardhmen. Monitorimi përfshin vendi-



met e gjykatës së Shkodrës rreth kërkesave të kujdestarisë të paraqitura në këtë gjykatë nga janari 2014 – korrik 2016. Rezultatet e hollësishme, të shoqëruara me tabelat që do të referohen më poshtë, gjenden ne Shtojcën 4.

Raste të Kërkesave për Përgjegjësi Prindërore në Gjykatën e Rrethit Shkodër

Nuk ka shumë për të thënë rreth kësaj çështje specifike. Gjatë 2014, 2015 dhe gjysmën së parë të 2016, nga 59 kërkesa kujdestarie, vetëm një i përket kategorisë së përgjegjësisë prindërore. Po ashtu, gjatë kësaj kohe, nuk ka asnjë kërkesë për heqjen e përgjegjësisë prindërore.

Vendime dhe Kohëzgjatja e Tyre për Çështje të Përgjegjësisë Prindërore

Figura 4.2. tregon qartësisht që kohëzgjatja mesatare e gjyqeve, për çështjet e përgjegjësisë prindërore dhe për kërkesa

të kujdestarisë alternative, është në rënie (të paktën gjatë periudhës të monitorimit). Në 2014, koha mesatare për dhënien e një vendimi për këto çështje ishte përafërsisht 100 ditë, ndërsa në 2016, është ulur pothuaj në gjysmën e të parës. Ky trend është një sinjal premtues drejt një gjykate me efikase. Sa për propocionin e çështjeve që kanë marrë një vendim përfundimtar gjatë vitit, ai ka qenë stabil gjatë kësaj kohe, në nivelin 45 % (Figura 4.8.).





Konkluzione dhe Rekomandime

Pas monitorimit në Gjykatën e Rrethit Shkodër dhe konsultimeve të vazhdueshme me specialistë të fushës, ne identifikuam disa probleme që rishfaqen shpesh në fushat e përgjegjësisë prindërore dhe rregullimit të foster care. Në përgjigje, poshtë problemeve, ky studim liston një sërë propozimesh, implementimet e të cilave mund t'a përmirësojnë situatën.

Konkluzione rreth Përgjegjësisë Prindërore

Barazia mes të dy prindërve në lidhje me përgjegjësinë

prindërore nuk ekziston në praktikë.

Vendimet e gjykatave nuk theksojnë mjaftueshëm prioritetin që kanë interesat e fëmijës.

Prindër me paaftësi fizike (të palidhura me aftësinë për të vepruar) shpesh diskriminohen.

Heqja e përgjegjësisë prindërore si dënim shtesë nuk është aplikuar kurrë.

Rekomandime rreth Përgjegjësisë Prindërore

- Implementimi i barazisë midis prindërve, pavarësisht gjinisë së tyre.
- Rritja e ndërgjegjësimin ndaj diskriminimit të padrejtë të prindërve me paaftësi fizike.
- Krijimi i ekspertizës për zgjidhjen e krizave familjare, që kanë ndikim negativ në çështjet e përgjegjësisë prindërore.
- Vënia e theksit tek prioriteti i interesave të fëmijës në çështje që përfshijnë përgjegjësinë prindërore. Aplikimi më i shpeshtë i heqjes së përgjegjësisë prindërore si një dënim plotësues.

- Përfshirja e dëmtimit indirekt të fëmijës si një arsye për heqjen e përgjegjësisë prindërore.
- Monitorimi sistematik i praktikave të gjykatave për sa i përket institutit të përgjegjësisë prindërore.

Konkluzionet e Foster Care

- Palët e interesuara janë minimalisht të informuara në lidhje me kornizën ligjore respektive.
- Programet e trajnimit, që kanë për qëllim formimin e ekspertizës, janë të pakta dhe kanë mangësi.
- Ka një kuptim të gabuar të "shërbimit të kujdestarisë" nga rregullimi që bën Kodi i Familjes dhe VKM 89 sa i takon familjeve kujdestare – e njohur si kujdestaria alternative.
- Edhe kur një familje kujdestare e mundshme identifikohet, procesi nuk implementohet sipas VKM nr.89. Komisionet multidisiplinarë të kujdestarisë pothuaj janë inekzistentë. Edhe në ato pak raste kur komisionet ekzistojnë, procedurat që janë ndjekur kanë qenë të paplota për sa


i përket trajnimit të familjeve kujdestare.

- Pretendimet në gjykatë për të njohur një familje kujdestare nuk zhvillohen sipas VKM nr.89 dhe familjet nuk janë të asistuar në proces (ndihma psikologjike dhe ligjore falas janë tërësisht të munguara).

Rekomandimet e Foster Care

- Fokusim më i madh tek familjet kujdestare.
- Monitorim sistematik i njësive lokale për sa i përket zbatimit të procedurave të identifikimit dhe vlerësimit të familjeve kujdestare.
- Më shumë trajnime për krijimin e ekspertizës së nevojshme.
- Ndjekja e një procedure të unifikuar për t'iu drejtuar gjykatës nga familjet kujdestare, sipas modelit të TLAS.
- Sigurimi i statistikave të sakta dhe të përditësuara për numrin e familjeve kujdestare dhe fëmijëve nën kujdestarinë e tyre.
- Rishikim i rregullimeve mbi familjet kujdestare në Kodin e Familjes.

Organigrama e Shërbimit Ligjor Falas Tiranë



Shërbimi Ligjor Falas Tiranë

Raste të kujdestarisë të gjykuara nga Gjykata e Rrethit Shkodër
për 2014, 2015, dhe 2016 (Projektim)²²

	2014	2015	2016
Nr. i plotë kërkesave për gjyq	18	20	42 ^{*24}
Kërkesa për përgjegjësi prindërore	0	1	0*
Kërkesa për heqjen e përgjegjësisë prindërore	0	0	0*
Kërkesa kujdestarie nga familjarë	11	4	14*
Kërkesa kujdestarie nga familje kujdestare	0	3	2*
Kërkesa kujdestarie nga institucione shtetërore	7	12	26*
Koha mesatare e gjykimit (në muaj)	3.45	2.9	1.9 ²⁵
Numri i çështjeve të apeluara	0	0	0*
Numri i vendimeve	18	20	42*
Numri i vendimeve përfundimtare	8	9	18*
Numri i vendimeve të ndërmjetme	10	11	24*



22 Duke qenë se procesi i monitorimit mbulon vetëm gjysmën e parë të vitit 2016, për qëllime krahasimore çdo e dhënë shumëzohet me dy. Kjo është një mënyrë e përafërt vlerësimi, jo domosdoshmërisht e saktë pasi periudha të ndryshme në një vit mund të kenë flukse të ndryshme në parametrat tonë të interesit.

23 Asterisku do të shërbejë si përkujtesë e pikës së mësipërme. Çdo numër në 2016 shumëzohet me dy, psh. në këtë rast, numri i plotë kërkesave deri në korrik të 2016 ishte 21.

24 Në këtë rast dyfishimi nuk ka kuptim pasi koha mesatare e gjykimit nuk ka lidhje (ose të paktën jo lidhje që mund të përcaktohet paraprakisht) me momentin që çështja vjen për gjykim.

Figura 4.1. Trendi i nr. të plotë të kërkesave




Figura 4.2. Trendi i kohës mesatare të gjykit




Figura 4.3. Trendi i nr. të kërkesave nga familje kujdestare




Figura 4.4. Trendi i nr të kërkesave nga institucione shtetërore




Figura 4.5. Ndarja e kërkesave të kujdestarisë proporcionalisht (2014)




Figura 4.6. Ndarja e kërkesave të kujdestarisë proporcionalisht (2015)



Figura 4.7. Ndarja e kërkesave të kujdestarisë proporcionalisht (2016)



Figura 4.8. Trendi i vendime përfundimtare si proporcion i të gjithë vendimeve



Konferenca, Takime, Seminare trajnimi, Tryeza të Rrumbullakëta, dhe Workshope – TLAS 2016

Seminare informuese dhe trainuese me punonjësit e njësive të institucioneve shëndetësore dhe ata të mbrojtjes së fëmijëve



Elbasan – 11 Mars, 2016

Takim me 35 profesionistë

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile”

Donator: UNICEF



Korçë – 15 Mars, 2016

Takim me 30 profesionistë

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile”

Donator: UNICEF



Gjirokastër – 18 Mars, 2016

Takim me 20 profesionistë

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile”

Donator: UNICEF

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë



Lezhë – 21 Mars, 2016

Takim me 33 profesionistë

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile”

Donator: UNICEF



Durrës – 25 Mars, 2016

Takim me 29 profesionistë

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile”

Donator: UNICEF



Durrës – 30 Mars, 2016

Tryeze diskutimi me 27 pjesëmarrës

Tema: “Të adresojmë me efektivitet çështjet ligjore që çënojnë të drejtat themelore të fëmijëve dhe të sigurojmë aksesin e tyre në drejtësi.”

Donator: UNICEF



Berat – 01 Prill, 2016

Takim me 34 punonjës nga Gjendja Civile, Arsimi dhe Shëndetësia

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes raportimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë mungesën e identitetit, kujdestarisë ligjore dhe të përfshirjes në programet sociale.”

Donator: UNICEF



Gjirokastrë – 08. Prill .2016

Takim me 20 punonjës nga Gjendja Civile, Arsimi dhe Shëndetësia

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes raportimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë mungesën e identitetit, kujdestarisë ligjore dhe të përfshirjes në programet sociale.”

Donator: UNICEF



Berat – 18 Prill, 2016

Takim me 30 profesionistë

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile”

Donator: UNICEF

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë



Kukës – 21 Prill, 2016

Takim me 32 profesionistë

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes rritjes së aksesit në drejtësi, bashkëpunimit me strukturat lokale dhe të shoqërisë civile”

Donator: UNICEF



Kukës – 22. Prill .2016

Takim me 27 punonjës nga Gjendja Civile, Arsimi dhe Shëndetësia

Tema: “Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijës përmes raportimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë mungesën e identitetit, kujdestarisë ligjore dhe të përfshirjes në programet sociale.”

Donator: UNICEF



Tiranë - 24 Prill, 2016

Konferencë Kombëtare e organizuar nga TLAS dhe CRCA, me 50 pjesëmarrës nga strukturat e mbrojtjes së fëmijëve

Tema: “Plani kombëtar i veprimit për sigurinë e fëmijëve në internet.”

Donator: UNICEF



Tepelenë – 28 Prill, 2016

Takim me 17 punonjës nga NJMF-të, Arsimi dhe Shëndetësia

Tema: “Mbrojta e interesit më të lartë të fëmijës përmes raportimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë mungesën e identitetit, kujdestarisë ligjore dhe të përfshirjes në programat sociale.”

Donator: UNICEF



Përmet – 29 Prill, 2016

Takim me 31 punonjës nga NJMF-të, Arsimi dhe Shëndetësia

Tema: “Mbrojta e interesit më të lartë të fëmijës përmes raportimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë mungesën e identitetit, kujdestarisë ligjore dhe të përfshirjes në programat sociale.”

Donator: UNICEF



Lushnje – 10. Maj .2016

Takim me 30 punonjës nga NJMF-të, Arsimi dhe Shëndetësia

Tema: “Mbrojta e interesit më të lartë të fëmijës përmes raportimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë mungesën e identitetit, kujdestarisë ligjore dhe të përfshirjes në programat sociale.”

Donator: UNICEF

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë



Vlorë – 20 Maj, 2016

Tryeze diskutimi me 25 pjesmarrës

Tema: “Të adresojmë me efektivitet çështjet ligjore që çenojnë të drejtat themelore të fëmijëve dhe të sigurojmë aksesin e tyre në drejtësi.”

Donator: UNICEF



Burrel – 24. Maj .2016

Takim me 30 punonjës nga NJMF-të, Arsimi dhe Shëndetësia

Tema: “Mbrojta e interesit më të lartë të fëmijës përmes raportimit të të gjitha formave të dhunës, përfshirë mungesën e identitetit, kujdestarisë ligjore dhe të përfshirjes në programat sociale.”

Donator: UNICEF



Tiranë – 10 Qershor, 2016

Konferencë advokuese me 36 pjesëmarrës

Tema: “Përmirësimi i mbrojtjes së të drejtave të të akuzuarve në BIH, Serbi, Kosovë, Maqedoni dhe Shqipëri.”

Donator: Balkan Rule of Law Network, BRLN



Durrës – 15 Qershor, 2016

Tryezë e rrumbullakët me 27 pjesëmarrës

Tema: “Akses i barabartë në drejtësi për fëmijët, barriera, dilemma dhe zgjidhje.”

Donator: UNICEF



Tiranë – 05. Shtator, 2016

Konferencë Advokuese – 36 pjesëmarrës

Tema: “Të mbrojmë fëmijët nga format e dhunës kompjuterike dhe internetit.”

Donator: UNICEF



Gramsh – 14 Tetor, 2016

Takim me 34 pjesëmarrës nga Bashkia Gramsh dhe profesionistë që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Tema: “Të rrisim aksesin në drejtësi duke ofruar shërbime ligjore falas në nivel lokal përmes krijimit të rrjeteve bashkëpunuese.”

Donator: MATRA

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë



Pukë – 17 Tetor, 2016

Takim me 20 pjesëmarrës nga Bashkia Pukë dhe profesionistë që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Tema: “Të rrisim aksesin në drejtësi duke ofruar shërbime ligjore falas në nivel lokal përmes krijimit të rrjeteve bashkëpunuese.”

Donator: MATRA



Shkodër – 21 Tetor, 2016

Takim me 36 pjesëmarrës nga Bashkia Shkodër dhe profesionistë që punojnë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Tema: “Të rrisim aksesin në drejtësi duke ofruar shërbime ligjore falas në nivel lokal përmes krijimit të rrjeteve bashkëpunuese.”

Donator: MATRA



Tiranë – 03 Nëntor, 2016

Tryezë e rrumbullakët me 28 përfaqësues të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjëndjes Civile, partnerë dhe grupe interesi, etj.

Tema: “Fuqizimi i familjeve në nevojë përmes regjistrimit civil, rekomandime për përmirësimin e procedurave ekzistuese.”

Donator: UNDP



Elbasan – 05 Nëntor, 2016

Seminar Trajnimi me 35 punonjës të zyrave të gjendjes civile

Tema: “Të sigurojmë mbështjetjen e gjithanshme për personat që rrezikojnë të mbeten pa shtetësi në Shqipëri.”

Donator: UNCHR



Fier – 12. Nëntor .2016

Seminar Trajnimi me 42 punonjës të zyrave të gjendjes civile

Tema: “Të sigurojmë mbështjetjen e gjithanshme për personat që rrezikojnë të mbeten pa shtetësi në Shqipëri.”

Donator: UNCHR



Tiranë – 17 Nëntor, 2016

Konferencë me 35 pjesëmarres nga Drejtoria e Pashtetësisë, me partnerë dhe aktivistë të grupeve të interesit, me studentë të Fakultetit të ligjit.

Tema: “Pashtetësia dhe çështjet që lidhen me të.”

Donator: European Network on Statelessness, ENS

Shërbimi Ligjor Falas Tiranë



Tiranë – 18 Nëntor, 2016

Seminar Trajnimi me 32 punonjës të zyrave të gjëndjes civile

Tema: “Të sigurojmë mbështjetjen e gjithanshme për personat që rrezikojnë të mbeten pa shtetësi në Shqipëri.”

Donator: UNCHR



Korçë – 25 Nëntor, 2016

Seminar Trajnimi me 34 punonjës të zyrave të gjendjes civile

Tema: “Të sigurojmë mbështjetjen e gjithanshme për personat që rrezikojnë të mbeten pa shtetësi në Shqipëri.”

Donator: UNCHR



Durrës – 12 Dhjetor, 2016

Seminar Trajnimi me 25 pjesëmarrës nga organizatat me bazë Komunitare Rome dhe Egjyptiane dhe aktivistët e tyre

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të aktivistëve dhe CBO’ve, aftësimi i tyre si paralegal në evidentimin dhe orientimin e problemeve ligjore të komunitetit.”

Donator: CRD



Tiranë – 13 Dhjetor, 2016

Seminar Trajnimi me 27 pjesëmarrës nga organizatat me bazë Komunitare Rome dhe Egjyptiane dhe aktivistët e tyre

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të aktivistëve dhe CBO’ve, aftësimi i tyre si paralegal në evidentimin dhe orientimin e problemeve ligjore të komunitetit.”

Donator: CRD



Elbasan – 14 Dhjetor, 2016

Seminar Trajnimi me 28 pjesëmarrës nga organizatat me bazë Komunitare Rome dhe Egjyptiane dhe aktivistët e tyre

Tema: “Ngritja e kapaciteteve të aktivistëve dhe CBO’ve, aftësimi i tyre si paralegal në evidentimin dhe orientimin e problemeve ligjore të komunitetit.”

Donator: CRD



Tiranë – 16 Dhjetor, 2016

Tryeze e rrumbullakët me 25 pjesëmarrës nga shkolla e magjistraturës, parlamenti, gjykatat, prokuroria dhe organizatat e shoqërisë civile

Tema: “Minimizimi i pengesave ligjore që hasin të miturit në kontakt me ligjin.”

Donator: UNICEF

Histori e Vërtetë I

MA dhe RA

Edhe pse jemi ne vitin 2016, në vitin kur MA mbush 31 vjec që ka lindur, ajo është një qenie njerëzore e padukshme ose jo "Visible" dhe jo e ligjshme për të gjitha strukturat shtetërore duke filluar nga zyra e gjendjes civile, nga cerdhja, kopshti, shkolla, ambulanca, spitali, shërbimi social, zyrat e punësimit,, dhe shumë zyra apo agjensi shtetërore të tjera që ofrojnë shërbime sociale, ligjore, komunale apo komunitare të bazuara së pari në dokumentin e identitetit personal. Kjo do të thotë që MA nuk njihet nga asnjë instancë e përmendur më lartë se ajo nuk ka një datë lindje, një vendlindje, baba, nënë apo seks të përcaktuar, si rrjedhim ajo jeton për mëshirë se nuk përfiton asnjë të drejtë themelore, ajo provon mohimin ekstrem të të drejtave njeriut, ajo sigurisht është dhe ka qenë deri sot njeriu më i fyer moralisht, psikikisht dhe mendërisht. Tërë këto situata penguese e diskriminuesëe sigurisht nuk mund të kalonin pa lënë gjurmë dhe pasojë në formimin dhe shëndetin e saj.

Duket e pabesueshme por është e vërtetë që MA ka mbijetuar duke vuajtur cdo ditë, orë, minutë të jetës së saj dhunimin, diskriminimin, harresën dhe neglizhimin më të egër si nga prindërit që e sollën në jetë, nga të afërmit, nga strukturat përgjegjëse të shtetit, edhe nga gjithë komuniteti e shoqëria. A është ky indiferentizëm rrënqethës dhe i frikshëm një sjellje kriminale fillimisht ndaj një krijese ëngjëll e sjellë në jetë nga prindër të papërgjegjshëm, më tej ndaj një fëmije, ndaj një adoleshenteje dhe tani ndaj një të rriture? Apo është pandëshkushmëria ndaj përgjegjësve qofshin ata prindërit e saj dhe institucionet vendim-marrëse, që i kanë hapur derën dhe kanë ushqyer situata të tilla që nuk janë të pakta

në numër??

TLAS u prezantua me MA vetëm kur ajo i kishte mbushur 31 vjecet.

MA ishte në gjëndjen që mund të deklaronte vetëm një të dhënë atë të emrit të babait i cili quhej ShA. Përpjekja e stafit të TLAS për të kontaktuar të jatën rezultoi pa sukses sepse ai kishte vdekur që në vitin 2014. Ajo personalisht e kishte të pamundur të jepte të dhëna qoftë edhe të përafërta lidhur me datën e saj të lindjes, vendin e lindjes, emrin e saktë të nënës, nëse kishte lindur në institucion shëndetësor apo jashtë tij.

Cfarë kishte bërë kjo femër apo grua në jetën e saj ishte shumë e vështirë t'ja zbuloje se kishte mungesë të theksuar kujtese dhe shprehjeje. Ajo aktualisht banonte në Tiranë, jetonte me frikën e rrezikut për jetën sepse vuante nga kanceri i gjirit, dhe ndërkohë ishte shtatzënë ne muajin e katërt ?!

MA kishte provuar të emigronte në Gjermani dhe jetoi atje për 9 muaj, deri ne momentin



që shteti gjerman u informua për qëndrimin ilegal dhe e deportoi brenda 10 ditëve në shqipëri. Ndërkohë ajo ishte e diagnostikuar me kancer dhe kur u kthye kishte nevojë urgjente për mjekim e trajtim. Por kur ju drejtua Qendrës Spitalore në Tiranë, ata nuk i shërbyen sepse nuk kishte anjë lloj mjeti identifikimi.

Duke u sorollatur si një qenie e padukshme, duke folur me disa të njohur të komunitetit Rome, ajo u rekomandua nga një ish përfitues i TLAS të paraqitej në zyrat tona. As nuk e mendonte MA që do gjendej një avokat falas cili do ta ndihmonte konkretisht dhe hap pas hapi të zgjidhte lëmshin e jetës së saj të koklavitur. Avokatja e TLAS e dëgjoi me vëmendje dhe sigurisht kuptoi që objektivi kryesor ishte regjistrimi i vet MA në regjistrin themeltar të Gjendjes Civile. Por që të arinte atje duhej hapur një proces gjyqësor, i cili në mungesë të dokumentave e provave nuk është i lehtë

për t'u realizuar. Mbas disa përpjekjesh, në mungesë të prindërve të saj u gjënd dhe u bind me shumë vështirësi xhaxhai i MA që të pranonte të vinte në zyrën e TLAS e të firmoste kërkesën padinë që do paraqitej në gjykatë për regjistrimin e faktit të lindjes së mbesës së tij. Dhe kjo për faktin se i ati i kishte vdekur dhe nuk kishim asnjë informacion për nënën që e kishte braktisur që kur ishte bebe.

Hapi i dytë i rëndësishëm ishte siguri i kujdesit shëndetësor për MA. Nga bashkëpunimi mjaft i mirë i TLAS me organizata të tjera si dhe institucione private e shtetërore u arrit që MA të shtrohej në institucionin spitalor (Martenitetin Koco Glozheni) për lindur fëmijën, djalin, edhe pse nuk kishte një mjet identifikimi. Ajo lindi djalë dhe sot ai është 18 muajsh.

Me mbarimin e procedurës gjyqësore për "Vërtetimin e faktit të lindjes" MA më në fund u identifikua si qenie njerzore duke u regjistruar zyrtarisht në gjëndjen civile te Njësisë Administrative nr. 4, Tiranë, ku sot figuron si jë familje bashkë me fëmijën e saj RA.

Identifikimi i nënës dhe i fëmijës i jep mundësinë asaj të njihet si single mother, kryefamiljare, me statusin e të cilës përfiton ndihmë ekonomike, dhe jo vetëm kaq jo mund të aksesojë shërbimet shëndetësore për vete dhe fëmijën e saj, ajo mund të aksesojë sistemin e edukimit për djalin, dhe sigurisht shërbime të tjera që ofrohen për qytetarët e ligjshëm si regjistrimi për strehim, për përfitim të bonusit të qerasë, për kartën e papunësisë, etj.

Emirjana Dimo

Avokate e TLAS



Histori e Vërtetë II

AT

Pranë TLAS u paraqit shtetasi AT, me të ardhura të pamjaftueshme për të marrë një avokat privat dhe parashitroi si problem mospërputhjen e të dhënave të gjëndjes civile për vajzën e tij me moshën reale të saj.

Nga verifikimet e bëra rezultuan këto fakte; Sipas çertifikatës së asistencës së lindjes (dublikatë) datë 7.09.2016, në Institucionin Shëndetsor "Materniteti nr. 2" Tiranë, më datë 2.12.1996, në qytetin e Tiranës ka lindur nga nëna E. ZH (bashkëshortja e kërkuarit) një fëmijë i seksit femër të cilës në regjistrimin në aktin e gjëndjes civile është quajtur J.

Kërkuari pretendonte se, për shkak të regjistrimit të vonuar, në momentin e deklarimit të lindjes dhe plotësimit të aktit të lindjes së fëmijës J, është regjistruar në mënyrë të pasaktë data e lindjes së fëmijës, nga data e saktë 2.12.1996 është regjistruar pasaktësisht data 2.12.1999.

Për të provuar faktin e pasaktësisë së regjistrimit kërkuari paraqiti prova shkresore, çertifikatë e asistencës së lindjes si dhe dokumentat e regjistrimit dhe të ndjekjes së shkollës nga ana e vajzës (dëftesat e shkollës).

Nga dokumentat e mësipërme rezultonte se ditëlindja e fëmijës ishte regjistruar pasaktësisht. Veç ndryshimit të kësaj date të lindjes në dokumentin e lëshuar nga Institucioni i lindjes, vlerë provuese kishin edhe dokumentat e shkollës, pasi nëse i referoheshim ditës së lindjes së regjistruar në aktet e gjëndjes civile, rezultonte që fëmija të kishte filluar ndjekjen e shkollës në një moshë shumë më të vogël se ajo e zakonshme.

Në këto kushte, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 8950 "Për gjëndjen civile" legjitimohej kërkuari, si deklarues i lindjes, për të kërkuar deklarimin e pasaktësisë dhe ndreqjen e gabimit të datës së lindjes së vajzës J, nga data e gabuar 2.12.1999 në datën e saktë 2.12.1996.

Sipas kësaj dispozite, "shtetasi, përfaqësuesi ligjor ose kujdestari, si dhe çdo person tjetër që pretendon se i është cënuar një e drejtë ose është privuar nga pasoja juridike të caktuara, pretendimet për pavlefshmëri, pasaktësi e fallsitet mund t'i parashtrijë vetëm gjyqësisht, duke thirrur si të paditur zyrën e gjëndjes civile, ku është mbajtur akti dhe deklaruesin, kur nuk është vetë paditës. Siç shihet kjo dispozitë ka përcaktuar qartë si kompetencën e organit që mund të ndreqë pasaktësinë ashtu edhe palët që do të marrin pjesë në një gjykim të tillë.



Me ndihmën e avokatit të Zyrës, është paraqitur kërkesa për gjykim dhe u realizua ndreqja e gabimit. Gabimet e punonjësve të gjëndjes civile në Shqipëri janë të konsiderueshme, por kur këto gabime cenojnë të drejtat e individëve vulnerabël ato mbarten nga dita në ditë, në muaj, në vite dhe nuk mund të korregjohen ndoshta kurrë sepse pikërisht këta individë nuk kanë mundësi financiare të marrin një avokat privat i cili minimumi do t'i kërkojë 40 000-50 000 leke si shpërblim për punën që do të bëjë duke e përfunduar në gjykatë, dhe kësaj shume i shtohen shpenzime të tjera gjyqësore që janë tarifa fikse të përcaktuara nga shteti për depozitimin e kerkese padisë apo për mbledhjen e dokumentave dhe të shpenzimeve noteriale, etj.

Pse Punonjësist e gjndjes civile qe i bejnë këto gabime nuk ngarkohen me kompesimin e këtyre dëmve? Kjo është një çështje shumë vjecare dhe që ka dëmtuar një numër të madh qytetarësh. Vetëm në TLAS gjatë muajit 2016 janë kryer 15 raste të drejtperdrejta me koregjimin e gabimeve që afektojnë jetët e femijëve, disa prej tyre me ruge administrative dhe disa më rrugë gjyqësore, por të gjitha kanë nevojë për asistencë ligjore e cila është një shumë e paërbalueshme për këtë katëgori që mbështetet nga TLAS.

Rudina Brari
Avokate e TLAS

